



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Illir Halili</b>	<b>04.06.2026</b>	<b>04.06.2026</b>	<b>2026/0355</b>

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.06.2026, OE “DWH-KOSOVA SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0355, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me drone profesional me saktësi të lartë” me nr. të prokurimit: "KEK-26-2890-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates: **30,000.00€**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Përmes kësaj shkrese, paraqesim kërkesën/ankesën tonë ndaj Autoritetit Kontraktues (AK), i cili në aktivitetin e prokurimit për furnizim me Fluturak (Dron) dhe Lidar, formalisht ka përzgjedhur procedurën e hapur, por de-facto është duke aplikuar procedurën me një burim (monopolizim të tregut).

FAKTI 1: Përcaktimi i specifikimeve ekskluzive

AK ka hartuar dosjen e tenderit duke përcaktuar në mënyrë direkte dhe të

identifikueshme:

1. Prodhuesin: DJI (Kinez)
2. Modelin e fluturakut (dronit): Matrice 300
3. Modelin e sensorit Lidar: Zenmuse L1
4. Për më tepër, AK ka kopjuar tekstualisht ("shkronjë për shkronjë" dhe "numër për numër", përfshirë edhe vlerat pas dhjetores) të gjitha specifikimet teknike të modeleve DJI Matrice dhe Zenmuse, duke shkelur hapur nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

FAKTI 2: Ndryshimet fiktive dhe thellimi i shkeljeve

Pas kërkesës sonë për rishikim të datës 19.05.2026, ku kërkuam harmonizimin e dosjes

me LPP-në, AK ka lëshuar një vendim për "aprovim të pjesshëm". Mirëpo, defacto dhe de-jure, AK nuk ka eliminuar diskriminimin, por vetëm ka zëvendësuar modelet

e vjetra me modelet më të reja të të njëjtit prodhues, siç dëshmohet në tabelën e

mëposhtme:

KERKESA FILLESTARE "E KORIGJUAR"

Prodhuesi DJI DJI

Tipi produktit Matrice 300 Matrice 400

Lidar Zenmuse L1 Zenmuse L3

1:1 Matrice 300 1:1 Matrice 400

1:1 Zenmuse L1 1:1 Zenmuse L3

Specifikimet teknike

1:1 DJI Aksesore 1:1 DJI Aksesore

Siç dokumentohet qartë, AK nuk ka hapur konkurrencën, por ka thelluar paragjykimin e tenderit në favor të një prodhuesi të vetëm. Ky "aprovim i pjesshëm" nuk ka asnjë përmbajtje substanciale. Përveç shkeljes teknike dhe juridike të LPP-së, kjo përbën edhe një shkelje të etikës profesionale të prokurimit publik.

Mbi bazën e këtyre argumenteve, nga OSHP KËRKOJMË:

1. Gjykim të drejtë dhe pjesëmarrje në seancë: Mbështetur në Nenet 31 dhe 32 të

Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kërkojmë të na garantohet e drejta

kushtetuese për tu dëgjuar dhe për të marrë pjesë aktive (me prani fizike/ballafaqim të palëve) në seancën shqyrtuese të panelit.

2. Anulimin e vendimit: Të anulohet vendimi i AK-së me nr. 3883, i datës 29.05.2026, dhe AK të urdhërohet që specifikimet teknike ti përshtatë në mënyrë neutrale dhe të hapur për konkurrencë, konform LPP-së së Republikës së Kosovës.

3. Gjithashtu AK nuk është përgjigjur brenda afatit të përcaktuar në ligjin e sipërpermendur.

#### KRITERET PËR VLERËSIM

DOsja e Tenderit - Specifikacioni teknik

#### RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(VENDFIMI MBI RISHQYRTIM)

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “DWH-KOSOVA SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dronë profesional me saktësi të lartë” me numër të prokurimit: “KEK-26-2890-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.

#### ANALIZA DHE SQARIMI I KOMISIONIT TE VLERESIMIT

Pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara pasi qe:

Autoriteti Kontraktues KEK sh.a ka vleresuar, shqyrtuar dhe krahasuar kerkesen konform LPP-se

Është zëvendësuar droni Matrice 300 me Matrice 400 (parametrat).

Është zëvendësuar LiDAR L1 me L3.

Është kërkuar që trajnimi të bëhet nga përfaqësuesi i DJI në Kosovë, meqë nuk mund të realizohet nga prodhuesi direkt, siç ka qenë në kërkesën e mëhershme.

Trajnimi kërkohej të realizohet nga trajnerë me minimum 5 vite përvojë profesionale në UAV LiDAR dhe me përvojë të dokumentuar në projekte topografike/infrastrukturore.

Janë hequr specifikat për transmetimin video dhe dimensionet e dronit.

#### REKOMANDIM I KOMISIONIT TE VLERESIMIT

Rekomandohet Drejtori i zyrës ekzekutive të Prokurimit që kërkesa për rishqyrtim e OE: DWH - KOSOVA SHPK për aktivitetin e prokurimit: Furnizim me dronë profesional me saktësi të lartë, me numer te prokurimit: KEKO-26-228-121 – KEK-26-2890-121 aprovohet si pjesërisht e bazuar

#### KONKLUZIONI I DREJTORIT TE ZYRES EKZEKUTIVE TE PROKURIMIT

Drejtor i zyrës ekzekutive të Prokurimit bazuar në kërkesën për rishqyrtim te OE DWH - KOSOVA SHPK i cili bazuar ne analizën, sqarimet dhe rekomandimin e njësisë kërkuese për aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me dronë profesional me saktësi të lartë** me numër te prokurimit: **KEKO-26-228-121-KEK-26-2890-121** APROVON si pjesërisht te bazuar kërkesën për rishqyrtim te OE DWH - KOSOVA SHPK

Këshilla Juridike:

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **DWH-KOSOVA SH.P.K.**

## Pretendimi nr.1

### Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor sipas ankesës 355/26 është se AK-KEK me rastin e njoftimit për kontratë, mirëpo edhe pas korigjimit të gabimeve ne dosje të tenderit, prap vendosur specifika të cilat shpien direkt te një prodhues i caktuar.

OE ndër të tjera pretendon se : "Pas kërkesës sonë për rishikim të datës 19.05.2026, ku kërkua harmonizimin e dosjes me LPP-në, AK ka lëshuar një vendim për "aprovim të pjesshëm". Mirëpo, defacto dhe de-jure, AK nuk ka eliminuar diskriminimin, por vetëm ka zëvendësuar modelet e vjetra me modelet më të reja të të njëjtit prodhues, siç dëshmohet në tabelën e mëposhtme: KERKESA FILLESTARE "E KORIGJUAR" Prodhuesi DJI DJI Tipi produktit Matrice 300 Matrice 400 Lidar Zenmuse L1 Zenmuse L3 1:1 Matrice 300 1:1 Matrice 400 1:1 Zenmuse L1 1:1 Zenmuse L3 Specifikimet teknike 1:1 DJI Aksesore 1:1 DJI Aksesore Siç dokumentohet qartë, AK nuk ka hapur konkurrencën, por ka thelluar paragjykimin e tenderit në favor të një prodhuesi të vetëm. Ky "aprovim i pjesshëm" nuk ka asnjë përmbajtje substanciale. Përveç shkeljes teknike dhe juridike të LPP-së, kjo përbën edhe një shkelje të etikës profesionale të prokurimit publik. "

Ne cilësi te ekspertit shqyrtues në mënyrë të pavarur kemi bërë hulumtime të mëtutjeshme dhe duke ju referuar specifikave teknik në dosje të tenderit kemi gjetur se këto specifika shpien në një prodhues dhe produkt konkret si më poshtë:

The screenshot shows a Google search interface. The search bar contains the text: "platformë industriale multirotor për aplikime profesionale. Dimensionet: Me propelerë : 430 x". Below the search bar, there are tabs for "AI Mode", "All", "Images", "Forums", "Videos", "Short videos", "Web", "More", and "Tools". The search results are displayed below, starting with an "AI Overview" section. The main result is titled "Specifikimet që keni listuar i përkasin drone-it profesional DJI Matrice 350 RTK i kombinuar me sensorin Zenmuse L2 (edhe pse në tekst keni përmendur emrin L1, të dhënat e performancës së kamerës si 1,200,000 pts/s multi-returns dhe saktësia vertikale 4 cm tregojnë specifikimet e sakta të gjeneratës më të re, Zenmuse L2)." and includes a YouTube link. Below this, there is a section titled "Platforma e Drone-it: DJI Matrice 350 RTK" with a list of features: "Struktura: Drone multirotor me distancë diagonale boshtesh prej 895 mm.", "Mbrojtja IP55: Rezistencë e lartë ndaj pluhurit dhe ujit, ideale për operime në kushte të vështira atmosferike.", "Pesha & Ngarkesa: Peshon 6.47 kg me dy bateri TB65. Mbështet një peshë maksimale gjatë ngritjes prej 9.2 kg (kapacitet ngarkese rreth 2.7 kg).", "Gati për Çdo Temperaturë: Operon pa problem nga -20 °C deri në +50 °C." To the right of the search results, there is a sidebar with "10 sites" and a list of related content, including "Enterprise Drone Platforms Comparison - Compare Matrice Series" and "DJI Matrice 350 RTK - Infini Drones". At the bottom of the search results, there is a "Pozicionimi Satelitor (RTK / GNSS)" section with a search bar and a microphone icon.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “DWH-KOSOVA SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dronë profesional me saktësi të lartë” me numër të prokurimit: “KEK-26-2890-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.

Bazuar në këto që u cekën më lart mendimi ekspertit është se pretendimet ankimorë janë të bazuara dhe kërkesat e dosjes së tenderit janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 dhe 28 të LPP-së.

#### REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “DWH-KOSOVA SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dronë profesional me saktësi të lartë” me numër të prokurimit: “KEK-26-2890-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOPORATA ENERJETIKE E KOSOVES sh.a.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOPORATA ENERJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **DWH-KOSOVA SH.P.K.**

**Ilir Halili**

